



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2375 Prot.

Rrogozhinë, më 29.05.2024

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Hënë datë 03.06.2024 ora 14:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- Miratim i rendit të ditës.
- Miratim i procesverbalit Nr.7, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 08.05.2024.
- 1- Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 2- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë ”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për emërtimin e një rruge në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim të VKB-së Nr.34, datë 27.12.2023 ‘Miratim i Paketës Fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’, i ndryshuar me VKB-në Nr.16, datë 02.04.2024 ”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 27.12.2023, ‘Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë për vitin 2024’ “, me qëllim përfshirjen në këtë vendim për caktimin e nivelit të pagave të Punonjësve të Policisë Bashkiake Rrogozhinë.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e projektit ‘Organizim eventit muzikor dhe humoristik në qytetin tonë për periudhën e stinës së verës datë 28 Korrik 2024’ “.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për shtimin e punonjësve sezonal plazhi (me kontratë) për periudhën Qershor - Gusht 2024”.
- 10- Shqyrtim i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.
(PBA do të prezantohet elektronikisht me video projektor nga drejtorja e financës).

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- 11- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit për masat e marra për korrjen e të lashtëve dhe masat e marra ndaj zjarrit.
- 12- Informacion nga sektori i shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH-së) mbi punën e bërë dhe çfarë propozohet për përmisimin e këtij shërbimi për periudhën Maj 2023-Prill 2024.
- 13- Informacion mbi sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullisor në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë.
- 14- Interpelancë me drejtorin e shërbimeve mbështetëse mbi furnizimin me bazë materiale të Institucioneve Arsimore në Bashkinë Rrogozhinë nga fillimi i vitit shkollor deri në ditët e sotme.
- 15- Të ndryshme.
 - Shqyrtim i kërkesës së maturanëve të Shkollës së Mesme të Bashkuar Gosë, për mbulimin e shpenzimit të transportit nga fondet e Bashkisë për ekskursionin e planifikuar nga ana e tyre.
 - Të tjera.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 31.05.2024 ora 10 : 30^{oo}, Komisioni i Verifikimit të Mandateve, me këtë përbërje : Shpati Kolgega - Kryetar, Silvana Aliu - Sekretare, Alime Hoxha - Anëtare. *(Për shqyrtimin e pikës 3 të rendit të ditës).*
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 31.05.2024 ora 11 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej-Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 31.05.2024 ora 11 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përberje : Lulzim Hasa - Kryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 31.05.2024 ora 12 : 00^{oo}, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit, me këtë përbërje : Sokol Gosa - Kryetar, Erind Tosku - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Fatmira Thartori - Anëtare, Besnike Coraj - Anëtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrrogozhine@gmail.com